

# VLERËSIMI I MËSIMIT ONLINE NË ARSIMIN E LARTË NËN NDIKIMIN E COVID 19



Koha e realizimit:  
Dhjetor 2020

QENDRESA  
QYTETARE



OLOF PALME  
INTERNATIONAL  
CENTER



# PËRMBAJTJE

1. HYRJE
2. METODOLOGJIA
  - 2.1 KAMPIONIMI
3. GJETJET KRYESORE
4. AKSESI I STUDENTËVE NË MËSIMIN ONLINE
  - 4.1 QASJA DHE KOSTOT E PAKETAVE TË INTERNETIT
5. PERFORMANCA DHE CILËSIA E MËSIMIT ONLINE
  - 5.1 VLERËSIMI I CILËSISË SË MËSIMIT DHE SHËRBIMEVE NDAJ STUDENTËVE
6. REKOMANDIME

*Ky botim u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projektit “Arsimi në Fokus”, me mbështetjen financiare të Olof Palme Center. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.*

# 1. Hyrje

Pas kalimit të një semestri të plotë nëpërmjet mësimit online, studentët e universiteteve publike dhe private prisnin të fillonin mësim në auditore, ashtu siç kishte paralajmëruar Konferenca e Rektorëve dhe Ministria e Arsimit në muajin tetor 2020.

Katër ditë para fillimit të procesit mësimor, në datën 30 tetor 2020, Komiteti Teknik i Ekspertëve të pandemisë covid-19 doli me një vendim duke sugjeruar që universitetet të zhvillojnë mësimin online si masë anti-covid. Organet drejtuese të universiteteve të gjendura të papërgatitura dhe të pa konsultuara me këtë vendim, ligjëruan sugjerimin e Komitetit dhe në datën 2 nëntor zyrtarisht nisi mësimi vetëm online në të gjitha universitetet publike dhe private.



Kjo situatë e gjeti të papërgatitur edhe komunitetin e studentëve të cilët, bazuar në njoftimet e MASR dhe Rektorëve kishin marrë të gjitha masat për fillimin e mësimit të alternuar duke paguar tarifën e konvikteve, shtëpive me qera dhe orendive të nevojshme për jetën e tyre studentore në bashkitë universitare. Java e parë e mësimit nisi me protesta të studentëve të cilët kundërshtuan zhvillimin e mësimit online duke e cilësuar si jo efektiv, nisur edhe

nga eksperiencën e tyre në muajt mars – gusht 2020.

Ky është vlerësimi i dytë i realizuar nga Qëndresa Qytetare brenda vitit 2020 mbi performancën, efektivitetin dhe mundësinë që kanë studentët për të ndjekur mësimin online dhe ka për qëllim evidentimin e problematikave sfidave dhe nevojave që kanë studentët dhe universiteti në këtë qasje të re të mësimit në distancë.

## 2. Metodologjia

Gjetjet e këtij studimi bazohen në një proces vlerësimi të qasjes digjitale të studentëve gjatë mësimit online dhe efektivitetit të mësimit në distancë në dy muajt e parë të vitit akademik 2020 – 2021. Vlerësimi është realizuar nëpërmjet një pyetësi online të realizuar me 610 studentë në 9 universitete publike të targetuara gjatë periudhës 1 – 10 Dhjetor 2020 dhe analiza e të dhënave mbështetet mbi përgjigjet të cilat kanë dhënë studentët.

Forma e realizimit të pyetësit u mundësua nëpërmjet përodrimit të programit “Google Form” duke u mbështetur nëpërmjet facebook ads. Për të siguruar gjithëpërfshirje, shpërndarje të drejtë dhe plotësim vetëm nga studentët. Pyetësi u kushtëzua të shfaqej në mënyrë rastësore vetëm për të rinjtë e moshave 18-24 vjeç në të gjitha fashat orare dhe në të gjithë territorin e vendit.



Pyetësi nuk u publikua në rrjetet sociale apo web, me qëllim shmangien apo minimizimin në maksimum të mundësisë së mbushjes së pyetësit nga më shumë se një herë nga i njëjti student apo mundësinë e shpërndarjes në grupe të cilat ndajnë qëndrime të unifikuara për çështjen.

U targetuan të rinjtë të cilët dedektohen nga rrjeti facebook si grup interesi të fjaleve kyçe “Universitet” “Student” “Arsim”.

Testimi i pyetësit u realizua me 20 studentë nga rrjeti i studentëve “Arsimi

në Fokus” para nisjes zyrtare të anketimit.



## 2.1 Kampionimi

Para përcaktimit të kampionit, stafi implemetues i projektit realizoi një përlogaritje të numrit të studentëve në secilin universitet të targetuar. Për të garantuar nivelin e besimit 95% me tolerancë gabimi jo më shumë se  $\pm 5\%$ , kampioni i përzgjedhur në të gjitha universitetet të marra së bashku ishte **610 studentë**, apo rreth 1% e popullatës. Niveli i besimit tek metodologjia e zbatuar për vlerësimin e mësimit online në fund të pyetësorit të projektit kërkimor ishte 95%. Statisticienët pranojnë një nivel prej 95% të besimit si një standart të pranueshëm, prandaj gjetjet e studimit janë të një niveli të lartë besueshmërie. Sa i përket pjesëmarrjes gjinore në këtë pyetësor, **71% e studentëve të pyetur janë vajza dhe 29% e tyre djem**. Ndërsa shpërndarja e studentëve të pyetur bazuar në ciklin e studimeve ka qënë propocionalisht e ndarë bazuar edhe në numrin real të studentëve që studiojnë sipas ciklit të parë dhe të dytë. **75% e studentëve pjesëmarrës në pyetësor i përkasin nivelit bachelor ndërsa 25% i përkasin nivelit master.**

### PJESËMARRJA NË PYETËSOR



Totali i pyetësorëve:  
**610 Studentë**




Shpërndarë në:  
**9 Universitete**



Forma: **Online**  
Koha: **1-10 Dhjetor 2020**  
Mosha: **18-24 Vjeç**

Universiteti	Nr. i pyetësorëve
Universiteti i Tiranës	150
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	90
Universiteti "Fan Noli", Korçë	42
Universiteti Politeknik i Tiranës	68
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	51
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	57
Universiteti Bujqësor i Tiranës	60
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	43
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	49

Gjinia 29% Djem  
71% Vajza



Niveli i Studimeve 75% Bachelor  
25% Master



### 3. Gjetjet kryesore



- Sipas sondazhit të Qëndresës Qytetare **77.5% e studentëve** e ndjekin mësimin online nëpërmjet **telefonit celular, e cila është forma më pak efiçente në raport me laptopin ose kompjuterin** nëpërmjet të cilit e ndjekin vetëm 20.5%, ndërsa nga tableti mesimi ndiqet nga 2% e studentëve.



- Mbi 2 Milion Euro në muaj përlogariten të jenë shpenzimet e studentëve për të aksesuar mësimin online**, dalë nga përgjigjet e tyre ku **50.6% e studentëve shpenzojnë 20 euro** në muaj për internet, 30.5% e tyre shpenzojnë **10 euro** ndërsa 18.9% e studentëve shpenzojnë **30 euro apo më shumë** për të blerë internet.



- 60% rezulton të jetë mesatarja e pjesëmarrjes së studentëve në seminare dhe leksione në 9 universitete.** Ndërkohë që 38.5% e studentëve janë shprehur se nuk janë respektuar oraret gjatë mësimin online.



- Megjithëse prej 7 muajsh universitetet po realizojnë mësim në distancë, MASR dhe Kuvendi nuk kanë marrë **asnjë iniciativë për të ndryshuar ligjin 80/2015**, me qëllim ligjërimit dhe përcaktimin e standarteve që e bëjnë të akreditueshëm këtë formë mësimdhënie.



- Studentët kanë vlerësuar me **notën 6 efektivitetin e mësimin online**, me **notën 7 - 8 gadishmërinë e pedagogëve** dhe me **notën 5 - 6 shërbimin e ofruar nga sekretarët** e fakulteteve, pra shërbimet të cilat bëhen të mundura direkt nga tarifat e studenteve vlerësohen shumë më pak se pedagogët të cilët paguhën direkt nga buxheti i shtetit




- Studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës e kanë ndjekur mësimin online në masë më të madhe 79%, ndërsa studentët e Universitetit "Aleksandër Moisiu" e kanë ndjekur mësimin online në masën më të vogël me vetëm 39%.

## 4. Aksesit i studentëve në mësimin online

Një nga sfidat kryesore të mëimit në distancë, për arsye të ndryshme ka qënë edhe aksesit i vazhdueshëm i studentëve në mësimin online. Bazuar në vlerësimin e Qëndresës Qytetare vetëm 60% e studentëve të pyetur kanë ndjekur rregullisht mësimin online ndërsa 40% e tyre nuk kanë pasur mundësi të ndjekin mësimin në distancë rregullisht.

Nëse i ndajmë përgjigjet e studentëve sipas universiteteve shohim që studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës e kanë ndjekur rregullisht në masë më të madhe mësimin online me 79%, ndërsa studentët e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, që kanë ndjekur rregullisht mësimin online janë në masën më të vogël nga 9 universitetet me vetëm 39%.

Për shumicën e studentëve (58% e tyre) arsyeja kryesore që i ka penguar për të ndjekur mësimin ka qënë mungesa e aksesit në internet, 17% shprehen se u kanë munguar pajisjet digjitale dhe 25% nuk e kanë ndjekur rregullisht mësimin online për shkak të mungesës së platformave dhe teksteve digjitale.




Nisur nga nevojat dhe specifikat që ka realizimi i mësimin në distancë, një nga sfidat kryesore përveç aksesit në internet është pajisja me infrastrukturë digjitale të përshtatshme e stafeve akademike dhe studentëve. Sipas të dhënave të sondazhit, 77.5% e studentëve e ndjekin mësimin online nëpërmjet telefonit celular, 20.5% nëpërmjet laptopit ose kompjuterit dhe vetëm 2% e aksesojnë mësimin online nga tabletat e tyre. Nisur nga mundësitë e pakta që ofron telefoni celular për të aksesuar dokumenta në microsoft office dhe për të ndërvepruar me detyra kursi, mund të themi që pjesa më e madhe e studentëve janë të kufizuar në pjesëmarrje cilësore në mësimin online.


## 4.1 Qasja dhe kostot e paketave të internetit

Sipas Raportit të Bankës Botërore të muajit qershor 2020, 50% e territorit të Shqipërisë mbulohet me internet më të dobët se 10mgb/sec, standart minimal i vendosur nga vendet e OECD për të garantuar mësim cilësor në distancë. Gjatë periudhës së mars – dhjetor 2020 ka pasur premtime dhe deklarata nga përfaqësuesit e qeverisë se do të mëbshtesin studentët në nevojë me paketa internet dhe pajisje digjitale por asnjë nag këto premtime nuk është kthyer në akt konkret dhe ndihmë reale për këto kategori. Për të vlerësuar nivelin e qasjes në internet dhe impaktin e blerjes së tij në buxhetin e studentëve impaktin Qëndresa Qytetare u drejtua me disa pyetje lidhur me qasjen në internet studentëve nga 9 universitetet publike të marra në vlerësim.

Cila është kostoja mujore e internetit për të ndjekur mësimin online?



Ju e siguron internetin nëpërmjet





Sa i përket mënyrës së sigurimit të internetit nga studentët, 61.4% e tyre e sigurojnë atë nëpërmjet blerjes së paketave në kompanitë e internetit, 29.3%, nëpërmjet blerjes së paketave telefonike ndërsa 9.4% e studentëve nuk kanë pasur mundësi të blejnë internet në asnjërën nga mënyrat. Ndërkohë arsyeja që 47.1% e studentëve që nuk kanë pasur akses të vazhdueshëm në internet ka qënë ekonomike ndërsa 52.9% nuk e kanë pasur mundësi teknike për të aksesuar internetin.

Studentët në Shqipëri kanë kosto të larta mujore për blerjen e librave, qeranë e shtëpive apo tarifatat e studimit, por gjatë zhvillimit të mësimin online blerja e paketave të internetit ka qënë një kosto e shtuar për buxhetin e tyre. 50.6% e studentëve shpenzojnë 20 euro në muaj për blerjen e internetit, 30.5% e tyre shpenzojnë 10 euro ndërsa 18.9% e studentëve shpenzojnë 30 euro e lart për blerjen e paketave mujore të internetit.

### Nëse nuk keni pasur akses në internet kjo ka qënë për arsye?



### Uljet e siguruar nga Karta e Studentit



Nga ana tjetër "Karta e Studentit" si një instrument i prodhuar për t'ju ardhur në ndihmë studentëve nëpërmjet shërbimeve dhe produkteve me çmime të reduktuara nuk ofroi shumë mundësi dhe lehtësira për oferta dhe paketa interneti. Shumica e studentëve (52%) janë shprehur se uljet e siguruar nga Karta e Studentit nuk kanë sjellë minimizim kostosh për blerjen e paketave të internetit, 45.4% e studentëve janë shprehur se nuk janë pajisur me Kartë Studenti dhe vetëm 2.6% e tyre shprehen se Karta e Studentit ka ndikuar në uljen e kostove të paketave të internetit që kanë blerë.


## 5. Performanca dhe cilësia e mësimit online

Megjithëse studentët e universiteteve publike dhe private prej 7 muajsh po ndjekin mësimin në distancë, Kuvendi dhe qeveria nuk ka marrë asnjë iniciativë për të ndryshuar ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Shqipëri me qëllim ligjërimitin e kësaj forme të mësimdhënies si dhe përcaktimin e standarteve që e bëjnë të akreditueshëm këtë formë. Por pavarësisht mos parashikimit në ligj pikëpyetja e madhe e mësimit në distancë në Shqipëri ka qënë shkalla e efektivitetit të tij. Për 52.2% të studentëve të pyetur nga Qëndresa Qytetare sfida kryesore e mësimit online është metodologjia e tij, 22% cilësojnë si sfidë aksesin në internet. 15.9% platformat digjitale të përdorura dhe 9.9% targetojnë si sfidë pajisjen e tyre me mjete digjitale.

Sipas jush cila është sfida kryesore e mësimit online?




Sa % e studentëve në kursin tuaj marrin pjesë në leksionet dhe seminarat online ?



\*60% përfaqëson mesataren e të gjitha përgjigjeve të dhëna nga studentët në pyetasor

A janë respektuar oraret e mësimit në degën tuaj të studimit?



Mësimin e keni zhvilluar nëpërmjet:



Nga qëndrimet dhe opinionet e studentëve të pyetur nga 9 universitetet publike, pjesëmarrja mesatare e studentëve në kurset e tyre të seminarëve dhe leksioneve është në masën 60%.


Respektimi i orareve të mësimit nga stafet akademike ka qënë një problematikë e vjetër, kur mësimi zhvillohej edhe në auditore, por studentët janë pyetur mbi këtë çështje gjatë mësimit në distancë. 38.5% e

studentëve janë shprehur se nuk janë respektuar oraret gjatë mësimit online, ndërsa 54.6% e tyre shprehen se oraret janë respektuar ndërsa 6.9% e tyre nuk janë përgjigjur lidhur me këtë pyetje.


Sa i përket mënyrës se mësimit 80.1% e studentëve pohojnë se e kanë zhvilluar mësimin nëpërmjet video takimeve në oraret e mësimit, ndërsa 16.8% shprehen se i kanë marrë leksionet vetëm nëpërmjet e-mailit. Vetëm 3.1% e studentëve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.

## 5.1 Vlerësimi i cilësisë së mësimit dhe shërbimeve ndaj studentëve

Për të kuptuar më mirë nivelin e ofrimit të shërbimeve akademike dhe administrative gjatë zhvillimit të mësimit online Qëndresa Qytetare pyeti studentet lidhur me efektivitetin e mësimit, përgatitjen e stafëve akademike dhe gadishmërinë e sekretarive mësimore për të ofruar informacionet dhe shërbimet që u janë dashur studentëve në këtë periudhë.







Vlerësimi me notë nga 4 (i ulët) deri në 10 (i lartë) është zgjedhur për ta paralelizuar me vlerësimet që marrin studentët në auditore por këtë herë janë studentët ata që vlerësojnë pedagogët dhe universitetin.

Bazuar në opinionet e studentët e 9 universiteteve publike efektiviteti i mësimit online vlerësohet mesatarisht me notën 6. Përgatitja dhe gadishmëria e pedagogëve gjatë mësimit online është vlerësuar mesatarisht me notën 7-8, ndërsa shërbimi i ofruar nga sekretaritë e fakulteteve vlerësohet mesatarisht me notën 5 - 6.


Studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës kanë vlerësuar me notë më të lartë pedagogët, sekretarinë dhe efektivitetin e mësimit, ndërsa studentët e UAMD kanë vlerësuar me notën kaluese 5, pra me një vlerësim të ulët këto tre matës të cilësisë së ofrimit të mësimit dhe shërbimeve.

Ky diferencim mes universiteteve shpjegohet edhe me mundësitë e pjesëmarrjes së tyre në mësimin online, ku sa më e altë ka qënë pjesëmarrja sipas studentëve aq më i lartë ka qënë edhe vlerësimi për këto tregues.



## 6. Rekomandime

- Qeveria duhet të akordojë një fond specifik në buxhetin e vitit 2021 për sigurimin e qasjes në internet dhe mjete digjitale për të gjithë studentët. Pajisja e tyre mund të realizohet në bashkëpunim me operatorët që ofrojnë internet dhe pajisje teknologjike nëpërmjet identifikimit me Kartën e Studentit ose regjistrat e universiteteve.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore për të parashikuar dhe njohur mësimin online (distance learning) si pjesë e formave të mësimdhënies në ligjin 80/2015.
- Universitetet publike duhet të përllogarisin një rivlerësim të tarifës së studimit duke marrë parasysh reduktimin e kostove administrative për shkak të mos përdorimit të ambienteve universitare.
- Qeveria shqiptare në bashkëpunim me universitetet duhet të fillojë procesin e digjitalizimit të teksteve universitare duke blerë të drejtat e autorit dhe integruar ato në bibliotekën digjitale.
- Universitetet publike duhet të përgatisin udhëzues mbi metodologjinë e vlerësimit të studentëve online përpara se të fillojë sezoni i provimeve dhe moduletë posaçme për sistemet e mbikqyrjes së mësimin online. Vlen të shqyrtohet modeli i monitorimit të mësimin në kohë reale të realizuar nga Universiteti i Prishtinës.
- Këshillat dhe organizatat studentore duhet të angazhohen për të identifikuar nevojat e studenëve për qasje në internet, mungesë të pajisjeve dixhitale dhe literature duke nisur një fushatë kombëtare donacionesh për mundësimin e aksesit në arsim të të gjithë studentëve.



QENDRESA  
QYTETARE



OLOF PALME  
INTERNATIONAL  
CENTER

